



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**-AUTORITETI I KONKURRENCËS-**  
**Komisioni i Konkurrencës**

---

Nr. \_\_\_\_ Prot.

Datë 23/06/2009

**VENDIM**  
**NR. 117 Datë 29.05.2009**

**“Mbi hetimin e thelluar në tregun e karburanteve”**

Komisioni i Konkurrencës, me pjesëmarrjen e:

<b>Lindita</b>	<b>MILO(LATI)</b>	<b>Kryetar</b>
<b>Lush</b>	<b>PËRPALI</b>	<b>Zv/Kryetar</b>
<b>Servete</b>	<b>GRUDA</b>	<b>Anëtare</b>
<b>Koço</b>	<b>BROKA</b>	<b>Anëtar</b>
<b>Rezana</b>	<b>KONOMI</b>	<b>Anëtare</b>

Në mbledhjen e tij të datës 05 dhe 29/05/ 2009, shqyrtoi çështjen me:

**Objekt:** Shqyrtimin e konkluzioneve të Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve

**Bazë ligjore:**

- Ligji Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”,  
nenet 24/d, neni 4/1, neni 3/4.
- Ligji Nr. 8485 datë 11. 11. 1999 “Kodi i Procedurave Administrative”

**Komisioni i Konkurrencës** pas shqyrtimit të:

- Raportit të Grupit të Punës të Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve;
- Relacionit të Sekretares së Përgjithshme dhe:
- Parashtrimeve (apo pretendimet) të palëve në seancat dëgjimore të datave 26.12.2008 dhe 26.01.2009;

## VËREN SE:

### I.PROCEDURA

1. Procedura e ndjekur gjatë hetimit është bazuar në Kreun II dhe III të Pjesës II të Ligjit Nr. 9121, datë 8.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe Ligjit Nr. 8485, datë 11.11.1999 “Kodi i Procedurave Administrative”.
2. Me nismën e tij, Autoriteti i Konkurrencës, filloi në muajin nëntor 2007 hetimin e përgjithshëm në sektorin e energjisë. Shkak për fillimin e këtij hetimi u bë shqetësimi i opinionit publik për çmimet e larta në këtë sektor sidomos në tregun karburanteve i prononcuar në median e shkruar si dhe kryesisht me ato të Shoqatës së Konsumatorëve dhe Konfindustrisë. Nga Komisioni i Konkurrencës, me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm, në bazë të nenit 24, germa d) dhe nenit 41 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, me vendimin Nr. 60 datë 12.11.2007 vendosi hapjen e hetimit të përgjithshëm në sektorin e energjisë, për të vërtetuar nëse konkurrenca në këtë treg kufizohet apo shtrembërohet.
3. Komisioni i Konkurrencës pasi shqyrtoi dhe administroi dokumentacionin e depozituar nga Sekretariati me Vendimin Nr. 74 datë 11.03.2008 vendosi hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve.
4. Në zbatim të këtij vendimi Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës ka kryer procedurat hetimore në përputhje me Ligjin Nr. 9121 datë 28. 07. 2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” dhe Kodin e Procedurave Administrative. Në përfundim të këtij hetimi, Sekretariati ka paraqitur Raportin e Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve, pranë Komisionit të Konkurrencës. Ky Raport, në zbatim të nenit 39 të ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës”, i ndryshuar, dhe nenit 47 të Kodit të procedurave Administrative, ju vu në dispozicion dhe shoqërive nën hetim, duke ruajtur të dhënat konfidenciale të palëve.
5. Në zbatim të nenit 39 të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003, “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, palët nën hetim dhanë pretendimet e tyre mbi Raportin e Hetimit të Thelluar në seancat dëgjimore të mbajtura, përkatësisht në datat 26 Dhjetor 2008 dhe 26 Janar 2009. Në këto seanca ata paraqitën pretendimet e tyre me shkrim dhe verbale në lidhje me përmbajtjen e raportit, të cilat janë marrë në konsideratë nga Komisioni i Konkurrencës në dhënien e këtij vendimi.

### II. Metodologjia

6. Metodologjia e përdorur në hetimin e tregut të karburanteve është e ngjajshme me metodologjinë që zbaton Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim në Evropë (OECD) për hetimin e karteleve pa evidenca

direkte<sup>1</sup> dhe mbështetet në nenin 3, pika 4 dhe nenin 4, pika 1 gërma a të ligjit nr 9121 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”, (i ndryshuar).

### III. NDËRMARRJET NËN HETIM

7. Hetimi i tregut të karburanteve përfshin ndërmarrjet, që zhvillojnë veprimtarinë e tyre në tregun e importit dhe të shitjes së karburanteve me shumicë.
8. Nën hetim janë 13 ndërmarrje<sup>2</sup> të shitjes me shumicë të karburanteve. Për nevojë të hetimit janë hetuar dhe ndërmarrjet e shitjes me pakicë<sup>3</sup> të integruara vertikalisht me këto ndërmarrje.
9. Ndërmarrjet nën hetim janë:
  - 1) Ndërmarrja **“ADA PETROL” SH.A**, person juridik shqiptar, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Rrethit Tiranë nr. 31313, datë 25.03.2004, me seli ne Adresën: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Kullat Binjake, Kulla 1, Zyra 6/1, Tiranë, me NIPT K47815502M,
  - 2) Ndërmarrja **“AL.P.IN” SH.A**, person juridik shqiptar, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. 34233, datë 27.10.2005, me seli ne Adresën: Rruga e Durrësit, ish-Shkolla e Partisë, Tiranë, me NIPT K21525001B,
  - 3) Ndërmarrja **“EUROPETROL DURRËS ALBANIA” SH.A**, person juridik shqiptar, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 26993, datë 18.01.2002, me seli ne Adresën: Lagjja “Hoxhe”, nr.12, Krujë, me NIPT K24010212N,
  - 4) Ndërmarrja **“FISHEKU” SH.A**, person juridik shqiptar, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Rrethit Tiranë nr. 22035, datë 29.09.1999, me seli ne Adresën: Lagjja “11 Janari”, Pallati 10 katesh, pas Shtëpisë së Oficerëve, Fier, me NIPT J82916543D
  - 5) Ndërmarrja **“Fit-Mek-Oil”, Sh.A**, person juridik shqiptar regjistruar me Vendimin e Gjykatës së rrethit Tiranë nr 36394, datë 25.10.2006, me seli në adresën Autostrada Tiranë Durrës Kashar, me NIPT K62303017P,
  - 6) Ndërmarrja **“GLOBAL PETROLEUM ALBANIA” SH.A**, person juridik shqiptar, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 21689, datë 20.07.1999, me seli ne Adresën: Rruga e Kavajës, nr. 59, Tirana Toëer, Kati IV, Tiranë, me NIPT J91923003C, me aksionar:

---

<sup>1</sup> [www.oecd.org](http://www.oecd.org)

<sup>2</sup> Renditja e ndërmarrjeve nën hetim është bërë në mënyrë alfabetike

<sup>3</sup> Këto të dhëna mbi ndërmarrjet e shitjeve me pakicë janë marrë nga faqja zyrtare e internetit të QKR, [www.qkr.gov.al](http://www.qkr.gov.al)

- 7) Ndërmarrja “**KASTPETROL**” **SH.A**, person juridik shqiptar, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 20885, datë 12.02.1999, me seli ne Adresën: Shkozet, Durrës, me NIPT J91823501N
- 8) Ndërmarrja “**KLODI**” **SH.A**, person juridik shqiptar, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. 21982, datë 14.09.1999, me seli ne Adresën: Lagjja 29 Nëntori, Fier, me NIPT J82916538N,
- 9) Ndërmarrja “**MAMIDOIL ALBANIA**” **SH.A**, person juridik shqiptar, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 21035, datë 15.03.1999, me seli në Adresën: Rr. “Murat Toptani”, Qendra “Gjergji”, Tiranë, me NIPT J91608006L,
- 10) Ndërmarrja “**RIRA**” **SH.A**, person juridik shqiptar, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Rrethit Tiranë nr. 21426, datë 02.06.1999, me seli ne Adresën: Rruga “Ali Demi”, nr. 49, Tiranë, me NIPT J91817005I,
- 11) Ndërmarrja “**ROMPETROL ALBANIA WHOLESALE**”, **SH.A**, person juridik shqiptar, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. 32477, datë 26.11.2004, me seli ne Adresën: Rr. “Ismail Qemali”, pall.2, Kati 1, Tiranë, me NIPT K42402801E. Kjo ndërmarrje sipas ekstraktit të datës 06.11.2008 të Qendrës Kombëtare e Regjistrimit që prej datës 07. 08. 2008 është në likuidim e sipër. Nga analiza ka rezultuar, që kjo ndërmarrje nuk ka pjesë tregu në asnjërin prej produkteve<sup>4</sup> (benzinë, eurodiesel/D1 dhe diesel/D2) për vitet 2007 dhe 2008, por në vitin 2005 ka patur pjesë të konsiderueshme në tregun e importit të D1- shit me 9.24% të tregut<sup>5</sup>.
- 12) Ndërmarrja “**TAÇI OIL INTERNATIONAL TRADING & SUPPLY COMPANY**” **SH.A**, person juridik shqiptar, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë nr. 27934, datë 24.06.2002, me seli ne Adresën: Rr. “Dëshmorët e 4 Shkurtit”, P.Sky Toëer, Kati IV, Tiranë, me NIPT K31902009J,
- 13)Ndërmarrja “**VILLOIL**” **SH.A**, person juridik shqiptar, regjistruar me vendimin e Gjykatës së Shkallës së parë Tiranë nr. 28154, datë 21.08.2002, me seli ne Adresën: Rruga e Malit Shëngjin, Lezhë, me NIPT K08502530K,

#### **IV: Periudha në hetim**

10.Ky hetim përfshin periudhën kohore nga muaji Shtator 2007 deri në muajin Shtator 2008

---

<sup>4</sup> Burimi i të dhënave janë të dhënat nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave t përpunuara nga Sekretariati i Autoritetit të Konkurrencës.

<sup>5</sup> Kompania Rompetrol është pjesë e hetimit të thelluar për efekt analize nga viti 2005. Kjo ndërmarrje aktualisht procedura falimentimi.

11. Për të parë sjelljen në një periudhë më të gjatë kohore Autoriteti i Konkurrencës ka analizuar tregun e shitjes së karburanteve me shumicë dhe para kësaj periudhe, duke marrë të dhëna nga ndërmarrjet që operojnë në këtë treg.

## **V. TREGU PËRKATËS**

### **V.1 Tregu përkatës i produktit**

12. Tregu i përkatës i produktit gjatë këtij hetimi i referohet tregut të importit dhe të tregëtimit me shumicës të karburantit për tre nëntregjet: nëntregu i produktit benzinë; nëntregu i produktit eurodiesel D1 dhe nëntregu i produktit diesel D2.
13. Për sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e kërkesës midis këtyre produkteve, për shkak të karakteristikave të ndryshme të përcaktuara në standardet përkatëse, D1 e konsiderojmë plotësisht zëvendësues të D2-shit, sepse automjetet që përdorin gazoilin D2 mund ta zëvendësojnë atë me D1. Ndërsa për sa i përket D2 konsiderohet si zëvendësues i afërt i D1-shit, pasi automjetet të cilat janë projektuar në katalogun e përdorimit për të përdorur D1 jo gjithmonë mund të zëvendësojnë me D2.
14. Sa i përket zëvendësueshmërisë nga ana e ofertës, rezulton se produktet eurodiesel D1, diesel D2 dhe benzinë për shkak të karakteristikave të ngjashme janë të zëvendësueshëm nga ana praktike si për importimin ashtu dhe depozitimin. Gjithashtu, ndërmarrjet që veprojnë në tregun me shumicë të këtyre produkteve mund të importojnë secilin nga produktet e tregut, sipas përcaktimeve të licencës, në varësi të kërkesës për këto produkte.

### **V.2. Tregu gjeografik**

15. Ndërmarrjet nën hetim e realizojnë shitjen e produkteve si dhe zhvillojnë veprimtarinë e tyre në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë. Për këto arsye, tregu gjeografik është Republika e Shqipërisë.

## **VI. STRUKTURA E TREGUT**

### **VI.1 Shkalla e përqendrimit të tregut**

16. Analiza e dinamikës së strukturës së tregut të importit dhe të shitjes me shumicë të karburantit janë përlogaritur bazuar në të dhënat për nivelet e importeve paraqitet në tabelat e mëposhtme sipas tre nëntregjeve përkatëse<sup>6</sup>.

---

<sup>6</sup> Të dhënat për importuesit e D1 janë marrë nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave dhe me pas janë përpunuar nga grupi i punës për përcaktimin e pjesëve të tregut për secilin importues

**Tabela VI.1.** Dinamika e pjesëve të tregut të ndërmarrjeve të importit dhe shitjes me shumicë të dieselit në vitet 2005-2008

Nr.	Kompanitë	2005	2006	2007	2008
1	Taci Oil	25.66%	23.93%	20.97%	24.77%
2	Kast Petrol	20.96%	24.63%	26.47%	24.64%
3	Europetrol	9.78%	8.57%	16.67%	22.92%
4	Mamidoil Albanian	7.07%	9.71%	5.72%	6.50%
5	Global Petroleum	4.92%	8.08%	8.64%	6.18%
	<b>Koeficienti i përqëndrimit (CR5)</b>	<b>79.59%</b>	<b>74.91%</b>	<b>80.11%</b>	<b>85.02%</b>

**Tabela VI.2** Dinamika e pjesëve të tregut të ndërmarrjeve të importit dhe shitjes me shumicë të eurodieselit/D1 në vitet 2005-

Nr.	Kompania	2005	2006	2007	2008
1	VILOIL	1,87%	28,99%	34,76%	38,58%
2	KAST PETROL	4,06%	7,98%	12,88%	14,19%
3	TACI	0,00%	20,12%	12,82%	13,47%
4	MAMIDOIL ALBANIAN	0,25%	2,78%	5,00%	6,76%
5	EUROPETROL	4,29%	16,04%	13,10%	6,46%
	CR5	75.94%	81.05%	81.90%	79.46%

*Tabela VI.3. Importuesit e licencuar te benzines dhe pjesët e tregut për periudhën 2005-2008*

Nr.	Kompania	2005	2006	2007	2008
1	KAST PETROL	24.48%	23.66%	21.58%	19.12%
2	EUROPETROL	13.42%	12.99%	17.01%	18.33%
3	VILOIL	6.18%	16.57%	15.93%	15.46%
4	GLOBAL PETROLEUM	15.72%	14.78%	13.56%	11.91%
5	MAMIDOIL ALBANIAN	12.24%	8.30%	9.21%	10.85%
	CR5	78.91%	76.56%	77.29%	75.68%

17. Tabelat e mësipërme tregojnë se tregu i importit dhe i shitjes me shumicë i karburanteve në Shqipëri ka një shkallë relativisht të lartë përqëndrimi pasi në të tre nëntregjet 5 ndërmarrjet kryesore kanë më shumë se 77 për qind të tregut. Për të tre nëntregjet: naftës D1, naftës

D2 dhe benzinës Koeficienti i përqëndrimit rezulton se 5 ndërmarrjet e para në tregun Eurodiesel(D1) është 79.46 %, në tregun D2 është 85.01 % dhe në tregun e benzinës 75.67% .

18. Për të matur përqëndrimin e tregut të karburanteve janë llogaritur idekset e përqëndrimit (Hirshman-Herfindal)<sup>7</sup> për të tre nëntregjet: naftës D1, naftës D2 dhe benzinës dhe rezulton se: nëntregu i benzinës është mesatarisht i përqëndruar (HHI = 1300).; nëntregu i eurodieselit/D1 është shumë i përqëndruar (HHI=2100); nëntregu i dieselit/D2 është shumë i përqëndruar (HHI=1900).

19. Ky përqëndrim i lartë i tregut, tregon se kemi të bëjmë me një strukturë oligopolistike në të tre nëntregjet ku ka pak ndërmarrje kryesore që përbëjnë pjesën më të madhe të tregut dhe një numër të konsiderueshëm ndërmarrjesh të vogla të cilat zënë një pjesë të vogël të tregut dhe ndjekin sjelljen e ndërmarrjeve të mëdha.

20. Pra rezulton se ndërmarrjet *“Taci Oil International Trading and Supply sha”*; *“Global Petroleum Albania sha”*; *“Europetrol Durres Albania sha”*; *“Kastpetrol sha”*; *“Viloil sha”*; *“Mamidoil Albania Sh.A”*, janë ndërmarrjet që kanë fuqi të ndjeshme në tregun importit dhe të shitjes me shumicë të karburanteve për automjetet

## **VI.2 BARRIERAT E HYRJES NE TREG**

21. Barrierat e hyrjes në treg janë një element i rëndësishëm i analizës së strukturës së tregut dhe për këtë arsye janë parë si barrierat ligjore/nënligjore ashtu dhe barrierat ekonomike me të cilat përballen ndërmarrjet në tregun e karburanteve për të operuar në këtë treg.

### **VI. 2.1 Barrierat Ligjore**

22. Që një ndërmarrje të jetë pjesë aktive në treg duhet që të pajiset me licencat përkatëse të parashikuara në Ligjin Nr. 8450 datë 24. 02. 1999, dhe në VKM Nr. 170 datë 25. 04. 2002, si dhe të ketë rezervat përkatëse të sigurisë sipas VKM Nr. 808 datë 05. 11. 2004. Pra, nuk ka ndonjë pengesë ligjore apo administrative për tu licensuar për tregtimin e karburanteve në tregun e Republikës së Shqipërisë.

### **VI.2.2 Barrierat Ekonomike**

23. Kostot për hyrjen e një ndërmarrje në tregun e shumicës janë të larta, për shkak të investimeve që kërkohen për ngritjen e depozitave, ngritjen e sistemit të shpërndarjes nëse integrohen ndërmarrjet vertikalisht, shumat

---

<sup>7</sup> Indeksi Herfindahl-Hirschmann (IHH) është matës specifik i përqëndrimit të tregut, domethënë i shkallës në të cilën një numër i vogël i firmave zënë një përqindje të madhe të tregut të produktit. IHH-ja përdoret si një tregues i mundshëm i fuqisë së tregut ose i konkurrencës midis firmave. Ky indeks mat përqëndrimin e tregut duke mbledhur përqindjet e tregut në katror të të gjitha firmave të industrisë. (HHI < 1000 - jo i përqëndruar, 1000 < HHI < 1800 - mesatarisht i përqëndruar, HHI > 1800 - shumë i përqëndruar)

dhe garancitë e nevojshme të likuiditetit për importin dhe pagesën e barrës fiskale në dogane (shpenzime doganore, Akcizë, taksë karboni TVSH etj.) si dhe shpenzimet administrative.

24. Ndërmarrja duhet të marrë parasysh edhe koston e daljes nga tregu, e cila është për shkak të një sërë kostosh të hyrjes dhe zhvillimit të këtij aktiviteti, konsiderohen të pakthyeshme ose kanë një normë të ulët kthimi në rast të rishitjes.

25. Gjithashtu fuqia ekonomike financiare e ndërmarrjeve ekzistuese në treg përben një barrierë për ndërmarrjet e reja. Ndërmarrjet e marra në hetim, për nga analiza e treguesve financiarë të ndërmarrjeve, janë ndërmarrje me një xhiro vjetore të konsiderueshme dhe kanë përfituar nga ekonomia e shkallës nëpërmjet integritit në rrjetin e shitjes me pakicë.

Për këto arsye, tregu përgjithësisht cilësohet se ka barriera të larta hyrjeje dhe daljeje për ndërmarrjet e reja që duhet të zhvillojnë veprimtarinë e tyre në këtë treg si për shkak të burimeve të konsiderueshme financiare që nevojiten

### **VI.3. INTEGRIMI VERITIKAL I NDËRMARRJEVE**

26. Ndërmarrjet e shitjes me shumicë të karburanteve, referuar Ligjit nr. 8450, datë 24.02.1999, "Për përpunimin, transportimin dhe tregtimin e naftës dhe nënprodukteve të tyre", nuk mund të ushtrojnë veprimtari në tregun e shitjes me pakicë, duke hapur stacione të shitjes së karburanteve dhe për këtë arsye, pjesa më e madhe këtyre ndërmarrjeve, nëpërmjet aksionarëve të tyre, kanë themeluar ndërmarrje të reja të cilat kanë si objekt të veprimtarisë së tyre shitjen e karburanteve me pakicë.

27. Nga evidencat rezulton se 5 ndërmarrje në nivelin e shitjes në rrjedhën e sipërme janë të integruara veritikalisht në tregun e rrjedhës së poshtme të shitjes me pakicë të themeluara nga këto ndërmarrje.

## **VII. SJELLJA E NDËRMARRJEVE NË TREG**

### **VII.1 Komunikimi për çmimet e ardhshme**

28. Autoriteti i Konkurrencës gjatë hetimit është njohur dhe me deklaratimet dhe publikimet e shumta në media. Të gjitha deklaratimet e dhëna në media, shërbyen për të parë nëse ndërmjet ndërmarrjeve kishte komunikim apo jo në lidhje me çmimet e ardhshme

29. Në median e shkruar janë publikuar deklaratatë të Sekretarit të Shoqatës së Hidrokarbureve si dhe nga importues të ndryshëm, sipas të cilave paralajmërohet rritje ose ulje e çmimit të shitjes së karburanteve.



30. Për vërtetimin e deklaratës së mësipërme u morën në shqyrtim ndryshimet e çmimeve të shitjes me pakicë<sup>8</sup>, nga analiza e të cilave rezultoi se kjo deklaratë është shoqëruar me ndryshim të çmimit nga ndërmarrjet:

- a. Kuid në datë 24.04-30.05.2008, çmim i cili nuk kishte ndryshuar që me 01.12.2007
- b. Eko rritja është shoqëruar nga 25.04.08-22.05.08 me 10 lekë për D1 12 lekë për D2 dhe 7 lekë për benzinë,
- c. Skënderi G ka pësuar një rritje për 3 lekë 24.04.2008 – 13.5.2008.
- d. Kastrati për periudhën 01.05-31.05.08 e rrit çmimin me 5 lekë për litër për produktet D1 dhe benzinë nga 140 lekë në 145 lekë për litër, çmim të cilin nuk e kishte ndryshuar që me 01.01.2008 për produktet D1 dhe benzinë.

Këto rritje çmimesh kanë filluar që të kryhen nga ndërmarrjet e integruara në tregun e shitjes me pakicë Kuid Shpk. vetëm 3 ditë (nga data 21 në datë 24 prill) pas deklaratës së bërë në media nga Z. Taçi dhe janë pasuar nga ndërmarrjet Skënderi G (24 prill), Eko (më datë 25 prill), dhe Kastrati (1 maj) brenda një periudhe të shkurtër (nga 1 deri në 8 ditë<sup>9</sup>).

21. Për vërtetimin e deklaratave të mësipërme u morën në shqyrtim ndryshimet e çmimeve të shitjes me pakicë nga ku rezultoi: Taci 12.08.08-20.08.08 për produktet D2 dhe Benzine bie me **5 lekë** për litër ndërsa për D1 bie me 4 lekë për litër, rënia vazhdon përsëri dhe me **5 lekë** të tjera për të tre produktet për periudhën 24.08.08-04.09.2008 **me 5 lekë**, për ndërmarrjen Elda, çmimet bien me 7 lekë me 07.08.08-18.08.08, për ndërmarrjen skenderi G për benzine çmimi bie me **5 lekë** me 02.08.08 ndërsa për dy produktet e tjera bie me 7 lekë litri, për ndërmarrjen Kastrati shpk ky çmim bie me 01.08.08-21.08.08 me 2-3 lekë për të tre produktet duke u pasuar me 22-25.08.08 me një rënie me 5 lekë për të tre produktet.

Deklaratat e mësipërme të bëra në media nga përfaqësues të ndërmarrjeve dhe Sekretari i Përgjithshëm i SHSHH, të shoqëruara me ndryshimet e çmimit, mund të konsiderohet si një evidencë indirekte komunikimi të cilat janë shoqëruar me veprime konkrete midis ndërmarrjeve objekt hetimi

## VII.2.2 Asimetria e reagimit ndaj ndryshimit të çmimeve

---

<sup>8</sup> Burimi i të dhënave për pikat 34-40 janë faturat e shitjes me pakicë të paraqitura nga palët dhe përpunuara nga grupi i punës.

<sup>9</sup> Burimi: faturat e shitjes se ndërmarrjeve

32. Evidenca ekonomike është një nga instrumentat që përdoret për të parë sjelljen e ndërmarrjeve. Ndryshimet e çmimit të karburanteve në tregun ndërkombëtar (për efekt të metodologjisë së vendosjes në kushte të barabarta pavarësisht burimit të furnizimit dhe kostove të transportit, është marrë çmimi në doganë së bashku me ngarkesën fiskale) janë krahasuar me ndryshimet e çmimeve në tregun e shitjes me shumicë dhe me pakicë për të gjithë tregun dhe për ndërmarrjet veç e veç.

33. Metodologjia e përdorur për vlerësimin e reagimit të tregut është bërë duke krahasuar çmimin mesatar mujor të karburanteve të llogaritur sipas të dhënave të doganës<sup>10</sup>, me çmimin mesatar mujor të shitjes<sup>11</sup> me shumicë dhe çmimin mesatar mujor të shitjes me pakicë<sup>12</sup> për tre produktet, D1, D2 dhe Benzine.

34. Paraqitja e të dhënave në forme tabelare dhe grafike tregon qartë mos-pasqyrimin e njëkohshëm dhe në të njëjtën masë të çmimit të shitjes karburanteve me shumicë dhe pakicë krahasuar me çmimin e doganës. Gjatë periudhës së rritjes së çmimit të karburanteve në doganë, tregtarët e shumicës reagojnë menjëherë. Gjatë periudhës së uljes së çmimeve në doganë, reagimi i tregtarëve është më i vonshëm dhe indeksi i uljes së çmimit nga tregtarët është më i vogël se indeksi i uljes së çmimit në doganë.

35. Gjatë vlerësimit të të dhënave janë marrë në konsideratë çmimet sipas bursës PLATTS<sup>13</sup>. Nëse do të krahasojmë grafikun e vlerave të bursës PLATTS me grafikun e çmimit të doganës do të vihen re luhatje të lehta të kurbës, të cilat janë ndikim i shpenzimeve të transportit<sup>14</sup>.

---


<sup>10</sup> Çmimi mesatar mujor i doganës është llogaritur mbi bazën e mesatares së ponderuar e llogaritur si raport i vlerës mujore të importit me sasinë (në litra) e importuar sipas llojit të karburantit. Vlera e importit përfshin Vlerën e faturës së blerjes + detyrim doganore (Akcize, TVSH dhe Takse karboni).

<sup>11</sup> Çmimi mesatar i shitjes me shumicë, është një çmim i llogaritur mbi një mesatare të thjeshtë të çmimit mesatar mujor i ndërmarrjeve të shumicës. Çmimi mesatar mujor i shitjes për çdo ndërmarrje është llogaritur si raport i vlerës së shitjeve mujore me sasinë përkatëse.

<sup>12</sup> E njëjta metodologji pune është ndjekur edhe për llogaritjen e çmimit mesatar mujor të shitjes me pakicë.

<sup>13</sup> Burimi: të dhënat janë marre nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave për Bursën Platss (Med-CIF).

<sup>14</sup> Çmimet sipas bursës PLATTS janë çmime të shitjes nga rafineritë (çmime FOB), ndërkohë që këtij çmimi i shtohen shpenzimet e transportit deri në portet e Shqipërisë (CIF) mbi të cilat llogariten detyrimet doganore.



*Grafiku 1: Krahasimi i çmimeve te D1 sipas çmimeve te bursës, shumicës, pakice dhe doganës*


36. Sipas të dhënave tabelore rezulton se diferenca mes çmimit të eurodiezelit në doganë për periudhën korrik 2008 dhe tetor 2008 është 20.28 lekë<sup>15</sup>, Nëse tregu do të kishte reaguar drejt ndaj ndryshimit të çmimit të doganës, të dyja nivelet e tregtimit duhet të kishin ulur çmimin me 20.28 lekë, ndërkohë që ndryshimi në nivelin e pakicës është 10.70 lekë.

37. Kjo duket qartë dhe nga grafiku<sup>16</sup> ku diferenca midis kurbës së çmimit të doganës dhe çmimit të pakicës është më e madhe gjatë periudhës korrik-shtator 2008.

38. Kjo analize është bërë edhe për dy produktet e tjera të cilat tregojnë të njëjtën sjellje të ndermarrjeve në të dyja nivelet e tregtimit për të gjithë tregun

<sup>15</sup> Çmimi I doganës ne tetor -çmimin e doganës ne korrik


<sup>16</sup> Ne grafik janë paraqitur të dhëna deri ne shtator 2008 pasi të dhënat nga ndermarrjet janë marrë deri në këtë muaj



*Grafiku 2: Krahasimi i çmimeve te D2 sipas çmimeve te bursës, shumicës, pakice dhe doganës*

39. Nga përpunimi i të dhënave rezulton se diferenca mes çmimit të diezELIT D2 në doganë për periudhën korrik 2008 dhe Tetor 2008 është 19.12 lekë<sup>17</sup>,

40. Nëse tregu do të kishte reaguar drejt ndaj ndryshimit të çmimit në dogane, të dyja nivelet e tregtimit duhet të kishin ulur çmimin me 19.12 lekë, ndërkohë që ndryshimi në çmimin e pakicës është 13.42 lekë.



*Grafiku 3: Krahasimi i çmimeve te Benzines sipas çmimeve te bursës, shumicës, pakice dhe doganës*

41. Nga përpunimi i të dhënave rezulton se diferenca mes çmimit të benzINË në doganë për periudhën korrik 2008 dhe tetor 2008 është 17.52 lekë, Nëse tregu do të kishte reaguar drejt ndaj ndryshimit të çmimit në doganë, të dyja nivelet e tregtimit duhet të kishin ulur çmimin me 17.52 lekë, ndërkohë që ndryshimi në nivelin e pakicës është 10.46 lekë.

<sup>17</sup> Cmimi i doganës në tetor - cmimin e doganës në korrik 2008

### **V.III NDIKIMI MBI KONKURENCËN I AKTEVE NORMATIVE TË ZBATUARA NË KËTË TREG.**

42. Njëkohësisht gjatë hetimit, Autoriteti i Konkurrencës ka shqyrtuar ndikimin e akteve ligjore dhe nënligjore që veprojnë në sektorin e karburanteve në funksionimin e mekanizmave të tregut në përgjithësi dhe të konkurrencës në vecanti. Kështu, është evidentuar ndikimi i kuadrit ligjor, nëpërmjet të cilit operojnë ndërmarrjet në tregun e karburanteve, efekti i barrës fiskale mbi çmimet e shitjes së karburanteve, ndryshimi i akcizës mbi këto të fundit, si dhe efekti i kursit të këmbimit të zbatuar nga organet doganore. Gjithashtu, janë marrë në konsideratë Udhëzimet e Ministrit të Financave.

43. Në seancat dëgjimore ndërmarrjet objekt hetimi paraqitën pretendime mbi praktikën e rivlerësimit të kryera nga Drejtoria e Përgjithëshme e Tatimeve, si praktika që i diktojnë të aplikojnë cmime të njëjta në të gjithë tregun. Evidencat që u paraqitën nuk shprehin qartë se keto praktika kanë ardhur si rezultat i mospasqyrimin të drejtë të çmimit të shitjes në dokumentat perkatese financiare apo të ndonjë arsye tjetër. Megjithatë keto praktika nuk mundesojnë gjykimin objektiv mbi sjelljen e ndërmarrjeve në tregun perkates gjatë periudhës objekt hetimi.

#### **PËR KËTO ARSYE:**

Komisioni i Konkurrencës, bazuar në nenin 24, germa d, nenin 28 germa a, të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003, "Për Mbrojtjen e Konkurrencës",

#### **VENDOSI**

1- Gjatë periudhës objekt hetimi, në tregun e importit dhe të shitjes me shumicë të karburanteve, evidencat nuk provojnë mjaftueshëm ekzistencën apo jo të sjelljeve të koordinuara në aplikimin e cmimeve të shitjes me shumicë midis ndërmarrjeve objekt hetimi .

2- Ngarkohet Sekretariati të zgjerojë monitorimin në tregun e :

- prodhimit vendas të karburanteve (Diezel) dhe shpërndarjes në nivelin e shumicës,
- të importit të benzines dhe eurodiezelit
- të shitjes me shumicë dhe pakice të karburanteve.

3. Ngarkohet Sekretari i Përgjithshëm të komunikojë këtë vendim ndërmarrjeve në hetim.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë

#### **KOMISIONI I KONKURENCËS**

**Lush Përpali**  
( \_\_\_\_\_ )  
**Zv/Kryetar**

**Servete Gruda**  
( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtare**

**Koço Broka**  
( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtar**

**Rezana Konomi**  
( \_\_\_\_\_ )  
**Anëtare**

**Lindita Milo (Lati)**

---

**K R Y E T A R E**

Datë 29/05/2009

## MENDIMI I PAKICËS

Lidhur me Vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr.117 Datë 29.05.2009 “Mbi hetimin e thelluar në tregun e karburanteve” kam mbajtur qëndrim kundra me aresyetimin e mëposhtem :

I-Për pikën 1 të dispozitivit të Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr. 117 datë 29/05/2009 “Mbi hetimin e thelluar në tregun e karburanteve” pra për pikën 1, jam për atë se:

Gjatë periudhës objekt hetimi, në tregun e importit dhe shitjes me shumicë të karburanteve, evidencat e prezantuara nga Grupi i Punës nuk provojnë mjaftueshëm ekzistencën e koordinimit të sjelljes midis ndërmarrjeve objekt hetimi.”

Por në aplikimin e çmimeve të shitjes me shumicë (zbatimin e praktikave të bashkërenduara për fiksimin e çmimeve finale të shitjes), ndarjen uniforme të pjesëve të tregut për nënproduktet-nëntregu i benzinës, nëntregu i eurodieselit/D1, nëntregu i dieselit/D2 dhe në çmimet e blerjes mungojnë të dhënat e siguruar nga Grupi i Punës për vlerën:

–çmimin e blerjes nga çdo ndërmarrje, për vlerën;

--çmimin e zhdoganimit (çmimi i blerjes+shpenzime transporti –sigurancione deri në doganë), që do konfirmonin ose jo koordinimin e sjelljes nga ana e ndërmarrjeve hetim e për rrjedhojë provat për zbatimin praktikave të bashkërenduara nga ana e firmave në këto momente të transaksionit të karburanteve, sikurse pretendohet në Raportin e Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve të datës 15 Dhjetor 2008. Njekohësisht evidencat e paraqitura nga Grupi i Punës nuk provojnë mjaftueshëm ekzistencën e koordinimit të sjelljes midis ndërmarrjeve objekt-hetimi

II- Përsa i përket pikës 2 të dispozitivit të Vendimit se:

“2-Ngarkohet Sekretariati të zgjerojë monitorimin në tregun :

- e prodhimit vendas të karburanteve(diezel) dhe shpërndarjes në nivelin e shumices,
- të importit të benzines dhe eurodieselit
- të shitjes me shumice dhe me pakice të karburanteve,”

jam dakort me këtë monitorim në vetvete.

Por kjo kërkesë, e natyrshme për çdo vendim Komisioni dhe punën e përditshme dhe funksionale të Autoritetit madje kompetencë ligjore e tij, mund të përdoret si justifikim për mangësitë serioze të vertetuara gjatë Proçedurës së Hetimit të Thelluar nga Grupi i Punës dhe Sekretariati.

Ky monitorim duhet bërë detyrimisht mbi bazën e një metodologjie shkencore të bazuar në fakte dhe në ligj dhe jo në konsiderata subjektive dhe/ose praktika administrative jointucionale, që janë verejtur gjatë Hetimit të Thelluar, nga

Grupi i Punës dhe Sekretariati. Ai nuk duhet të jetë një zëvendësues i një procesi hetimor, objektiv të paanshem, por të hedhë dritë mbi qëllimet e vendimmarrjes, mbi sanksionet dhe masat rregulluese, korektuese të tij.

Duke qënë dakord me pohimin që thuhet në Raportin e Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve se :”...rritja e çmimit të doganës reflektohet në çmimin e shumicës dhe pakicës në mënyrë të menjehershme; ndërkohë, ulja e çmimit të importit gjatë periudhës gusht –tetor nuk është reflektuar në të njëjtën kohë dhe me të njëjtën masë në çmimet e shitjes me shumicë dhe pakicë për ndermarrjet e integruara”<sup>1</sup>, vërejt se nuk ka vlerë të shtuar lidhur me pohimin e kësaj dukurie të evidentuar edhe në hetimin e përgjithshëm në sektorin e energjisë; për të sqarimin se: pse ka ndodhur përsëritja e kësaj dukurie të vërtetuar edhe në vitet 2005-2007? Kush është shkaku real kryesor i saj ? Etj.

Në praktiken ndërkombëtare, (madje edhe në legjislacionin vendas të fushës) është e njohur se pengesat dhe kufizimet e konkurrencës mund të imponohen edhe nga organet shtetërore, si dhe mund të jenë rrjedhojë e akteve imponuese nga ana e tyre.

Personalisht i përmbahem qëndrimit të shprehur në mbledhjen e Komisionit të Konkurrencës në datë 15.12.2008 ku u shqyrtua nga “Raporti i Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve “ se “Unë nuk e miratoj raportin”<sup>2</sup> me arsyetimin se “Ky Raport s’është bindës, ka eliminuar prova esenciale” .

Eliminimi i provave esenciale, nga Grupi i Punës në këtë proces hetimor dhe qëndrimi refraktar si nga ana e Grupit të Punës, ashtu edhe nga ana e Sekretariatit në periudhën më pas, jo vetëm që ka komprometuar hetimin duke i hequr objektivitetin dhe paanshmërinë për të mbështetur në fakte dhe në ligj, por për më tepër duke shërbyer si një precedent mund të kompromentojë edhe hetime të tjera nga Sekretariati i Autoritet të Konkurrencës, duke e shndëruar atë më tepër në një organ i cili nuk po ka më përparësi për kujdesjen për mbrojtjen dhe rivendosjen e konkurrencës së lirë dhe efektive në treg. Në këtë rrafsh zëvendësimi i një hetimi të paanshem objektiv të mbështetur në fakte, prova dhe në ligj dhe interpretimi i saktë i tyre, me një hetim që eliminon provat esenciale dhe shmangia prej tyre dhe e interpretimit subjektiv për to nga njëra anë; si dhe kalimi në një monitorim të mevonshëm nga ana tjetër, është një praktike që nuk i shërben mbrojtjes së konkurrencës së lirë dhe efektive në treg dhe zbatimit të Ligjit Nr. 9121, datë 28.7.2003 “PER MBROJTJEN E KONKURRENCES”. Qëndrimi kundër-ndaj Vendimit të Komisionit të Konkurrencës Nr.117 datë 29.05.2009, shpreh para se gjithash dhe mbi të gjitha në thelb mospajtimin ndaj qëndrimit të Grupit të Punës, për eliminimin e provave esenciale nga ana e tij të cilat po i prezantoj më poshtë.

---

<sup>1</sup> Raporti i Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve date 15. Dhjetor 2008, faqe 74

<sup>2</sup> Shih Proçesverbalin e mbledhjes së Komisionit të Konkurrencës datë 15.12.2008.



III-Shenjat e kufizimit dhe shtrebbërimimit te konkurrencës te evidentuara ne Raportin “Mbi hetimin e përgjithshëm në sektorin e energjisë” .

Mbështetur në konstatimet e Grupit të Punës të Raportit “Mbi hetimin e përgjithshëm në sektorin të energjisë”<sup>3</sup> se :

- a) Në një studim të Tregut të Hidrokarbureve nga ana e Sektorit të Analizës dhe Studimeve të Autoritetit të Konkurrencës dhe monitorimeve te kryera nga Sektori i Autoritetit të Konkurrencës, rezulton se Tregu i Energjise, në përgjithësi dhe Nëntregu i Hidrokarbureve, në veçanti, ka shfaqur shenja të kufizimit dhe shtrebbërimimit të konkurrencës duke mos reflektuar çmime të një konkurrence efektive në treg”<sup>4</sup>;

Në gjetjet kryesore të atij Grupi pune evidentohet se :“si konkluzion, raporti arrin në përfundimin se tregu karakterizohet nga konkurrenca e pamjaftueshme në tregun e hidrokarbureve” :

b) dhe “..tregu i karburanteve nuk është transparent”<sup>5</sup> . ;

c)<sup>6</sup>-Më tej shprehet po aty se “...vërejmë se rritja e çmimit ne vendin tone bëhet me të njëjtën shkallë , si edhe ne vendet e tjera të Evropës, pra shohim se trendi i ndryshimit të çmimit në rastin e rritjes së tij është i njëjtë me atë të vendeve evropiane. Por nuk mund të themi të njëjtën gjë në rastin e uljes së çmimit, pasi kjo ulje në vendin tonë reflektohet në një masë shumë të vogël krahasuar me vendet e tjera të Evropës dhe kjo duket edhe nga pjerrësia më e vogël që karakterizon kurbën e ndryshimit të çmimeve të vendit tonë në vitet 2005-2007...Gjithashtu shohim se në vendin tonë ka pasur rritje të çmimit nga viti 2005 deri nga mesi i gjashtëmujorit të dytë të 2006-s, ndërkohë që në vendet e tjera të Evropës ka pasur një ulje të çmimeve në gjashtëmujorin e parë të 2006. Ndërsa ulja tjetër e çmimeve në fillim të 2007-s është reflektuar edhe ne vendin tonë, por ne nje nivel më të ulët.”

d) Ekziston një prove filmike e deklarates se njerit prej anëtarve të Shoqatës se Hidrokarbureve se “...mblidhen për të diskutuar normat e fitimit në 10 lekë për liter”<sup>7</sup>

e) Po kështu per ndërrmarrjet nën hetim ka vend për opsionin që <sup>8</sup> “të pranojnë të shesin shumë me pak duke aplikuar nje norme të lartë fitimi për shitjet të realizuara” , pra realizohen norma të larta fitimi dhe deformime të tjera që shpien në shtrebbërimime të konkurrencës në treg.<sup>9</sup>

f) <sup>10</sup> Që ”Përcaktimi i çmimit të importit për naftën dhe benzinën vendoset nga bursa PLATTS si pasoje e të ciles çmimi i hidrokarbureve është afërsisht i njëjtë

---

<sup>3</sup> Raporti “mbi hetimin e përgjithshëm ne sektorin e energjisë “ Autoriteti i Konkurrencës Shkurt 2008, faqe 57

<sup>4</sup> Shih po aty faqe 4-5.

<sup>5</sup> Shih po aty faqe 57

<sup>6</sup> Shih po aty faqe 55

<sup>7</sup> Shi po aty ne faqe 57 dhe Plani i Veprimeve te hetimit te thelluar ne tregun e karburanteve , date 16.5.2008

<sup>8</sup> Shih po aty faqe 56

<sup>9</sup> Korsivi eshte I imi

<sup>10</sup> Shih po aty faqe 51”

për të gjithë subjektet”;<sup>11</sup> Nga informacioni i grumbulluar rezulton që mes furnizuesve dhe subjekteve importuese nuk ka kontrata afatgjata dhe çmimet e blerjes përcaktohen nga bursa dhe vleresohen sipas çmimit CIF” :

g) dhe propozimin e këtij Grupi: Në bazë të nenit 43 të ligjit 9121, datë 28.07.2003 “Për mbrojtjen e Konkurrencës” e bëjnë të domosdoshëm nisjen e një hetimi të thelluar, që do t’i shërbente Autoritetit të Konkurrencës për të qartësuar shtrembërime të cituara me lart të konkurrencës në këtë treg”;

- Sa më sipër kam mbështetur pa rezerva vendimin e Komisionit të Konkurrencës Nr. 74 datë 11.03.2008 “Për Hapjen e procedurës së Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve” ndaj ndërmarrjeve me fuqi të ndjeshme në treg, duke presupozuar dhe kërkuar kryerjen e nje hetimi të plotë, objektiv e të paanshëm, të mbështetur në prova dhe në ligj .

Po kështu gjej te drejta veprimet e para te grupit të punes kur është hartuar Plani dhe Matrica e Veprimeve në tregun e karburanteve.

1) Në “Planin e veprimeve, të Grupit të Punes për hetimin e thelluar ne tregun e karburanteve”<sup>12</sup> thuhet “Objektivat e hetimit te thelluar, -Metodologjia/te e hetimit sipas te cilave :-“duke pasur parasysh qe objektivin kryesor te hetimit, pra gjetjen e provave per nje marreveshje ose kordinim sjellje se ndërmarrjeve në treg, e bëjnë të nevojshme dhe të domosdoshme kryerjen e inspektimeve për gjetjen e këtyre fakteve”

2) “Matricen e Veprimeve në tregun e Karburanteve”<sup>13</sup> ku parashikohej qe përgatitja e Raportit përfundimtar për Komisionin e Konkurrencës dhe propozimet për masen e gjobës mbështetur mbi analizen e praktikës antikonkurrese të përfundonte në Qershor 2008.

#### IV – Eleminimi i provave esenciale.

Eleminimi I analizave dhe provave esenciale, mbi “shenjat e kufizimit dhe shtremberimit të konkurrencës” të evidentuara nga Grupi i Punës që ka hartuar Raportin “Mbi hetimin e pergjithshem në sektorin e energjise elektrike”

Gjatë procesit të hetimit të thelluar në tregun e karburanteve dhe Raportit përkatës, vihet re si dukuri kryesore se:

Nga njëra ana kalohet nga pohimi se, “tregu i hidrokarbureve ka shfaqur shenja të kufizimit të konkurrencës mos reflektuar në çmime të një konkurrence efektive në treg,” në akuzën “Mbi marrëveshje të ndaluar (praktike e bashkërenduar) mes gjashtë ndërmarrjeve në Tregun e Karburanteve”; ndërsa nga ana tjetër shmanget analiza e hipotezave dhe sjelljes të provave esenciale mbi të cilen ishin argumentuar shenjat e kufizimit te konkurrences.

Në mënyre më të detajuar ato paraqiten si më poshtë.

<sup>11</sup> Po aty faqe 46

<sup>12</sup> Plani I Veprimeve te Grupit te punes per hetimin e thelluar ne tregun e karburanteve date 16.5.2009

<sup>13</sup> Shih MATRICE E VEPRIMEVE NE TREGUN E KARBURANTEVE –DATE 27/03/2008

Është për t'u vënë në dukje se grupi i punës për Hetimin e Tregut të Karburanteve ka ndryshuar si në përberje ashtu dhe në drejtim. Kjo ka ndodhur se dy pjesëmarrës të grupit të punës, një nga të cilët ka qënë bashkëkryetar, janë larguar nga institucioni i Autoritetit të Konkurrencës.

Së bashku me këtë ndryshim ka ndodhur ndryshimi i metodologjisë së hetimit, nga ajo se <sup>14</sup> duke pasur parasysh objektivin kryesor të hetimit, gjetjen e provave për një marrëveshje ose kordinim sjellje së ndërmarrjeve në treg <sup>15</sup> në një metodologji tjetër sipas të cilës; - "Metodologjia e përdorur në hetimin e tregut të karburanteve është e ngjashme me metodologjinë e zbatuar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim në Evropë (OECD) (në fakt lexo Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik-shënim i imi) , për hetimin e karteleve pa evidenca direkte dhe mbështet në nenin 3, pika 4 dhe nenin 4 pika 1 gërma a të ligjit Nr 9121 "Për mbrojtjen e konkurrencës."

Së bashku me këtë "ndryshim metodologjie", dhe në funksion të " metodologjise" se re, u bë dhe realizimi i një praktike administrative jo institucionale, ku Grupi i Punës, ka shmangur praktiken elementare administrative për të evidentuar se kush punoi dhe kush miratoi këtë apo atë shkresë (material); nuk janë mbajtur procesverbale të rregullta e të plota të diskutimeve, qofte për ndryshimet metodologjike të realizuara dhe nuk gjen mendimet të njejta apo ndryshme brenda për brenda grupit. (procesverbale sporadike ekzistojnë) . Për rrjedhojë në Raportin e Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve, ndryshimi i metodologjise paraqitet i realizuar pa asnjë diskutim, duke përjashtuar në të njëjten kohë, provat, analizat dhe duke eliminuar në mënyrë të vetdijshme prononcimin e ballafaqimiit të gjetjeve në këtë fazë të hetimit me gjetjet e shenjave të kufizimeve të konkurrencës gjatë hetimit të përgjithshëm, (të cilën më poshtë po e quaj faza paraprake).

IV-a) Në se në fazën paraprake evidentohet "...tregu i karburanteve nuk është transparent"<sup>16</sup>. "Përcaktimi i çmimit të importit për naftën dhe benzinën vendoset nga bursa PLATTS, si pasojë e të cilës çmimi i hidrokarbureve është afërsisht i njëjtë për të gjithë subjektet". Pikërisht kjo piste shmanget si në konkluzionet e Grupit të Punës dhe në këtë vazhde është ecur edhe në argumentimin e vendimit nga ana e shumicës.

Kjo ndodh ndërkohë kur anetaret e Grupit të Punës janë njohur se në bazë të "Udhëzimit të janarit 2006 të Drejtorise së Përgjithshme të Doganave". Mbi Burimet e Informacionit dhe Afatet e Publikimit të Dosjes me të dhëna të disponueshme", pika 2-Afatet e azhurnimit dhe publikimin e çmimeve , për Naftë dhe nëprodukte të saj a) Karburantet (benzine ,gazoil, mazut vajguri), afati i publikimit është çdo ditë.

---

<sup>14</sup> Shi Planin e Veprimit të Grupit të punës date 16.5.2008

<sup>15</sup>

<sup>16</sup> Shih po aty faqe 57

Tregues i rëndësishëm i kësaj transparence është pa dyshim publikimi i References per Karburantet.

Këto të dhëna janë shmangur nuk janë pasqyruar asnjëherë në kohe reale nga Grupi i Punës, por vetëm në mënyrë të sfazuar dhe këto të shprehura në USD/ton, kur akciza apo analizat e tjera janë paraqitur në litër dhe karburantet tregetohen me litra.

Qendrimi ndaj transparences ne tregun e karburanteve, te dhenat mbi cmimet e burses PLATTS apo prezantimi i referencave te perdorura gjate periudhes hetim kane munguar dhe jane eliminuar në Raportin e Hetimit të Thelluar në Tregun e Karburanteve. Kur jane prezantuar te dhenat e cmimeve ne bursen PLATTS paraqiten ne USD/ton, kur akciza paraqitet ne lek per liter<sup>17</sup>. Kur kerkohen qe te dhenat te jepem ne te njejten njesi matse te dhenat per bursen PLATTS, shifrat paraqiten te ndryshme nga ato te prezantuara me pare ose te dhenat mbi cmimet e references te perdorura nga dogana nuk jepen<sup>18</sup> Por a mund të hetohet e provohet qendrimi i bashkerenduar i firmave në këtë treg, cmimi prezantuar ne faturën doganore, duke perjashtuar analizen ne se ky bashkerendimin eshte e shkaktuar prej tyre jashtë dhe pamvarësisht nga ndikimi i dyshemesë bursës PLATTS dhe tavanit Cmimit të Referencës, apo eshte rrjedhoje e pashmangeshme e ketyre te fundit dhe rregullores se si hartimit te fatures doganore per karburantet?! Të mos harrojme se po vete Grupi i punes gjate hetimit paraprak ka pohuar se ne kushtet kur burimi eshte i njejte Bursa PLATTS :- “ si pasojë e të cilës çmimi i hidrokarbureve është afërsisht i njëjtë për të gjithë subjektet”

Cmimet e references per karburantet nuk jane prezantuar ne Raportin e hetimit te Thelluar megjithse edhe Komisionere te tjerë kane kerkuar që Autoriteti i Konkurrencës te shihte efektin e perdorimit te gjere te cmimeve te references ne treg. Nga Grupi i punës për hetimin e thelluar në rastin më te mirë eshte bërë prezantimi i te dhenave te bursës PLATTS ne \$/ton ose ne Lek/kg, kur të dhenat e tjera siç thame jane ne lek/liter.

Në mungesë të të dhenave të Burses PLATTS në \$ për fuçi, apo \$ për liter, Lek për liter, dhe sidomos të çmimeve të referencës të përdorur nga dogana per karburantet, tendenca per cmime te njejta të përcaktuara nga nje burim i perbashket (bursa PLATTS) dhe nje rregull i perbashket,(cmimi i references te perdorur) nuk eshte e mundur ose eshte veshtire te dallohet se sjellja e bashkerenduar eshte imponuar nga organet shteterore, apo eshte nje sjellje e bashkërenduar si rezultat i bashkepunimit te firmave ne treg.

IV-b) Gjate Raportit te Hetimit paraprak eshte evidentuar :”Nga informacioni i grumbulluar rezulton që mes furnizuesve dhe subjekteve importuese nuk ka kontrata afatgjata dhe çmimet e blerjes përcaktohen nga bursa dhe vleresohen sipas çmimit CIF” :

Në këto rrethana ishte e pritshme që Grupi i punës por dhe Komisioni i Konkurrencës të vihej në dijeni se si paraqitet ecuria e çmimeve CIF të ndërmarjeve nën hetim gjatë periudhës hetimore. Cmimet CIF vërtet kanë një

<sup>17</sup> Shih Raporti I Hetimit te Thelluar ne Tregun e Karburanteve Aneks 5

<sup>18</sup> Shih Memo e Sektorit Te studimeve dhe Analizave date 23/04/2009

bazë të njëjtë, bursën PLATTS, por siç dihet kjo burse ndryshon cdo dite, jo te gjithë blejne ne nje dite, kursi i USD ndryshon cdo dite, shpenzimet e transportit dhe të siguracionit jane te ndryshme (behen me burime te veta ose me mjete transporti me qira qe mund te jene te firmave te ndryshme).  
Pra ne kushtet normale cmimet jane te ndryshme.

Ne kushtet e marreveshjes se ndaluar/praktikave te bashkerenduara ato jane ... Si kane qene ne fakt? Kjo pyetje kerkonte nje pergjigje qe do te jepte hetimi i kryer nga Grupi i Punes dhe jo shmangie te ketij hetimi dhe provave perkatse ne emer te ashtuquajtures "perdorim i metodës se OECD-se". Megjithë pyetjen e bere se si paraqiten keto cmime Grupi i Punes i eshte shmangur kesaj pyetje dhe nuk ka dhene pergjigje.

Vetem pas sigurimit te ketij informacioni nga procesi i hetimit te thelluar, komisioni mund te gjykoj ne se ka ose ska marreveshje te bashkerenduara ne kete faze te procesit te tregetimit apo ajo eshte krijuar nga veprimtaria e ndonje organi shteteror sic eshte Drejtoria e Pergjithshme e Doganave  
Pra aty ku duhet të fillonte hetimi i shpalosur vetë nga Grupi i Punes në fazën e hetimit paraprak, përjashtohet ai. Pa kete hetim, hetimi nuk mund të jetë i plotë i sakte dhe akuza per sjellje e te bashkerenduar e pa mbeshtetur ne fakte dhe prova.

Në Raportin e Hetimit te thelluar ne tregun e karburanteve analizohet ajo qe nga Grupi i Punes quhet çmimi i doganes (jo çmimi CIF ne faturë) i cili sipas ketij Grupi nenkupton çmimin e faturës +detyrimin doganor (ku ne detyrimin doganor perfshihet akciza, taksa e karbonit, TVSH e mbajtur ne doganë, por edhe efekti i referencave doganore). Përjashtimi i analizes së çmimit CIF në dogane, kufizon për të mos thënë përjashton gjetjen e shkakut real te vertete të tendences per cmime te njejta (praktika të bashkerenduara) në se ato jane përcaktuar nga firmat marreveshja e ndaluar apo praktika e bashkerenduar e tyre apo nga kerkesa e organeve shtetërore (doganore). Kjo është nje nga elementet, ku mbështetet qendrimi im në mbledhjen e datës 15/12/2008 se Raporti s'është bindës ka eliminuar prova esenciale. Megjithate ndaj kesaj verejtje Grupi i Punes dhe Sekretariati ka mbajtur nje qëndrim refraktar duke bere te paditurin, por duke mos reflektuar mbi "padijen" e tij .

Nje hetim objektiv i plote i paanshëm do trajtonte problemet e transparences, do duhej te ndriçonte rolin real të çmimeve te references te perdorura ne dogane sidomos ne nje treg ku burimi i fillestar i furnizmit te cdo ndermarrje qe importon karburante, eshte një burim i njejte me çmime transparente siç është bursa PLATTS.

IV-c) Ecuria e cmimeve sipas burses PLATTS, cmimeve te references dhe cmimit te cdoganimit (vleres doganore pa detyrimet doganore) .

Per te pasur nje gjykim te plote mbi faktoret qe kane përcaktuar cmimet CIF, cmimin e cdoganimit (pa detyrimin doganor) ne mungese te hetimit dhe te dhenave nga Grupi i Punes, iu referuam dosjes \*\*.

Sipas kesaj dosje ecuria e cmimeve te burses PLATTS, References, doganore, dhe cmimit CIF te aplikuar per periudhen hetimore Shtator 2007-Gusht 2008 (te dhenat e muajit Shtator 2008 mungojne), te prezantuara nga ndermarrja \*\*\* paraqiten ne Tabelen Nr.1

Tabela nr 1

b) Dinamika e cmimeve të cdoganimit dhe references doganore per periudhen Shtator -2007-Shtator 2008

Nr	Muaji	Platts \$/ton	Referenca	Cmimi I cdoganimit
1	2	3	4	5
1	Shtator 2007	712.2	693.97 684.02	693 683
2	Tetor 2007	739.8	715	713
3	Nentor 2007	862.8	742	740
4	Dhjetor 2007	830.8	899 855.96	899 854
5	Janar 2008	816.2	899	899
6	Shkurt 2008	879.6	814	814
7	Mars 2008	981.5	902	902
8	Prill 2008	1044.6	989	989
9	Maj 2008	1202.2	989	989
10	Qershor 2008	1236.7	1082	1082
11	Korrik 2008	1231.0	1288	1286
12	Gusht 2008	1042.6	1304	1304
13	Shtator 2008	938.1		
14	Tetor	717.9		

Burimi i te dhenave, dosja e e te dhenave te derguara nga firma X”

1.Nga analiza e te dhenave, cmimeve te burses PLATTS dhe cmimeve te References, te tabeles nr. 1 rezultojnë disa dukuri. Per me se 8 muaj ( Shtator, Tetor, Nentor 2007 ; Shkurt, Mars, Prill, Maj, Qershor 2008) cmimi i References ka qene me i ulet se sa ai i burses PLATTS. Ndersa per kater muaj (Dhjetor 2007, Janar 2008, Korrik e sidomos Gusht 2008) cmimi i references eshte me i larte se sa ai i zyres PLATTS. Ketu duhet thene se nuk ka asgje te keqe, qe cmimi i references te jete me i larte se sa ai i burses PLATTS, per me teper kjo nuk eshte vetem e nevojshme por eshte edhe e domosdoshme. Pas cmimit te burses PLATTS ka disa shtesa te domosdoshme ne strukturen e cmimeve CIF,(që eshte prezantuar qarte ne hetimin paraprak) sic jane shpenzimet e transporti, pagesa per sigurimin e mallrave etj Ne keto kushte cmimi i references nuk mund te jete kursesi me i vogel se sa ai i burses PLATTS. Por kjo jo vetem ju eshte lejuar por edhe sipas te dhenave te tabeles Nr 1 u eshte orientuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave.

2. Ajo që vihet re nga të dhënat e tabelës Nr.1 është se në kushtet kur ka një rënie të cmimit në bursat ndërkombëtare, nga Drejtoria e Përgjithshme Doganave vihet re rritja e cmimeve të referencës. Si e tillë kjo veprimtari shfaqet si shkak i asaj dukurie të pohuar si në hetimin paraprak por edhe në hetimin e thelluar që kur ulen cmimet në tregun ndërkombëtar kjo rënie të mos reflektohet në tregun shqiptar. Pra dukuria e evidentuar në hetimin paraprak e paska midis të tjerash bazën në mënyrën e aplikimit të referencave. Mungesa e transparencës në tregun e karburanteve e shoqëruar me këto praktike punë të organeve shtetërore ka ndikuar dhe ka përcaktuar këto dukuri që ekzistojnë në tregun shqiptar që e bën atë të dallueshëm nga ai në tregun evropian. Por këto fakte dhe prova esenciale janë eliminuar (fshehur) në Raportin e Grupit për Hetimin e Thelluar në Tregun e Karburanteve. Për më tepër këtu kemi të bëjmë jo thjesht me një moszbulim të provave por është një qëndrim i vetëdijshëm i Grupit të Punës për Shmangien e tyre. Kjo praktike e Grupit të Punës dhe Sekretariatit është e patolerueshme dhe cenon rëndë veprimtarinë e Autoritetit të Konkurrencës në teresi dhe atë të Komisionit në vecanti.

3. A ka probleme, deformime dhe shenja të kufizimit të konkurrencës, tregu i karburanteve sic është evidentuar në hetimin paraprak? - Po ka. Por detyrë e Grupit të Punës dhe Autoritetit të Konkurrencës është të zbulohen cilat janë realisht këto deformime, jo vetëm shenjat por dhe evidencat, provat për kufizimit, pengimit, apo shtremberimit të konkurrencës në këtë treg, të provuara gjatë hetimit të thelluar, duke zbuluar në mënyrë objektive dhe shkakun dhe shkaktarin real të tyre. Në ndihmë të kësaj shërbejnë të dhënat e kolonës 5 mbi cmimet e cdoganimit (cmimi i faturës CIF në doganë) Sipas të dhënave rezultojnë cmimi i cdoganimit për ndermarrjen në fjalë është i njëjti thuajse identik me atë të cmimit të referencës.

4. Por cilat janë pasojat e kësaj dukurie? Në kushtet kur cmimi i referencës është më i ulët se sa ai në bursë kjo do të thotë se cmimi CIF, është më i vogël se cmimi i blerjes.

Në të gjitha rastet kur cmimi i Referencës është më i vogël se sa ai i bursës PLATTS. Kjo dukuri është shmangur nga Grupi i Punës që ka realizuar hetimin e thelluar në tregun e karburanteve. Mungesa e një hetimi të plotë për këto çështje nuk hedh dritë se si është vepruar nga ndermarrjet e tjera nën hetim. Ndërsa shkalla e bashkërendimit për nivelin e cmimit është ndikuar dhe përcaktuar nga bursa PLATTS dhe cmimet e referencës, nuk përben prova për sjelljen e bashkërenduar të firmave. Përvetësisht nga kjo, të dhënat e mësipërme provojnë se tregu i karburanteve është i deformuar për shkak të qëndrimit të mbajtur nga organet shtetërore doganore. Natyrisht kjo nuk e justifikon sjelljen e ndermarrjes, që cmimi i cdoganimit të jetë i barabartë me cmimin e referencës, që do të thotë se është më pak se cmimi i bursës PLATTS. Kjo praktike dëshmon se cmimi i referencës i realizuar në këtë mënyrë, është një legjislacion dhe praktike që nuk shmang evazionin fiskal apo deformime të tjera që kanë të bëjnë me praktika antikonkurrense. Për rrjedhojë ai duhet të ishte dhe duhet të jetë objekt i veprimtarisë të grupit të punës në procesin e vlerësimit të akteve ligjore dhe nenligjore.

5. Per te patur nje gjykim, real, objektiv te paanshem nga ana e Komisionit te Konkurrences Grupi i punes duhet te prezantonte ne Raport dhe prane ketij Komisioni, se sa kane qene cmimet e references (cmimi i references edhe sipas burimit te ndermarrjeve te tjera dhe Drejtorise se Pergjithshme te Doganave) dhe cmimet e cdoganimit per cdo ndermarrje nen hetim.

Nga analiza e te dhenave te tables nr.1 rezulton se edhe muajin Gusht 2008 vihet re dukuria se: ndersa cmimet e karburantit ne tregun nderkombetar ulen kjo nuk ndodh me te njejtin ritëm ne vendin tone per shkak se rriten cmimet e references ndersa nga ana tjeter vlere e cdoganimit eshte percaktuar percaktuar nga cmimet e e references Per rrjedhoje kjo dukuri dhe praktiket paralele te ndermarrjeve nen hetim jane percaktuar nga veprimtaria e organeve doganore

IV-d) Shmangia e hetimit te shenjave te kufizimit te konkurrences ne treg te evidentuara ne hetimin paraprak, gjate procesit te hetimit te thelluar.

Siç është paraparë edhe nga dispozitivi i vendimit të Komisionit të Konkurrences Nr 74, datë 11/03/2008 “Per Hapjen e Proçedurës së Hetimit të Thelluar ne tregun e Karburanteve”<sup>19</sup>, mbështetur në propozimin e grupit të punës dhe ne faktin se analiza e gjetjeve të shenjave të kufizimeve të konkurrencës në tregun e karburantit ishte berë për periudhën 2005, 2006, 2007, periudha hetimore u la e hapur për ti mos i krijuar asnjë pengese grupit të punës, për gjetjen e evidencave, provave dhe fakteve të tjera që do konfirmonin dhe provonin shkeljen dhe shtrembërimin e konkurrencës në Tregun e Karburanteve, sidomos kur ne tregun nderkombetar po viheshin re luhate shume te medha ne tregun e karburanteve. Por periudha hetimore e realizuar nga Grupi i Punes shtator 2007-tetor 2008 i ka shmangur nga procesi i gjetjes te evidencave dhe provave, mbi dukurite e deformimit te tregut te karburanteve dhe shkaqet reale te shenjave te kufizimit te konkurrences, te prezantuara ne hetimin paraprak.

IV-e) Norma e fitimit

Ne Raportin “Mbi hetimin e pergjithshem ne sektorin e energjisë” kur evidentohen shenjat e kufizimit te konkurrences thuhet se “realizohen norma te larta fitimi”, “...normat e fitimit ne 10 lek per liter” Ndersa ne Raport pohohet se Normat e fitimit te 13 Ndermarrjeve te mara nen hetim jane nga -3 ne 3 %, dhe vetem ndermarrja X sh.a qe po shkon drejt falimentimit ka hasur nje norme fitimi prej 8 % ne vitin 2007.

Ne vend te hetimit se pse ka ndodhur kjo dukuri; ne vend te dhenies së fakteve mbi bazen e evidencave se sa ka qene norma e fitimit në terma absolute per liter dhe te gjykimit objektiv per to; proçedura e hetimit zëvendesohet me nje qendrim tautologjik sipas të cilit: “Nga tabela e mesiperme vihet re qe midis ndermarrjeve ka uniformitet ne pjesë te qendrueshme te ardhurash dhe norma relativisht te barabarta fitimi. Nje treg konkurrues jep variacione te ndryshme te nivelit te fitimit midis firmave. Ne disa raste niveli i fitimit mund te jete rruga e vetme per te dalluar nese nje perberes i cmimeve te njejtja ne treg reflekton kordinimin te sjelljes”

---

<sup>19</sup> Shih Vendimin e Komisionit të Konkurrences Nr 74, Datë 11/03/2008 „Per hapjen e Proçedurës së Hetimit të Thelluar ne Tregun e Karburanteve”



Ky qendrimi i grupit te punes dhe i sekretariatit flet per magesi serioze dhe shmangie nga hetimi dhe provat thelbësore. Nderkohe konstatohet qendrimi ne "bllok" i grupit te punes dhe sekretariatit. Nje qendrim i tille atrofizon veprimtarine e Autoritetit te Konkurrences e ben ate te paafte te realizoje objektivin per mbrojtjen e konkurrences se lire dhe efektive ne treg duke e kthyer atë ne nje insitucion te pabesueshem jo vetem per biznese por edhe per mua si komisioner. Per rrjedhoje qe ne mbledhjen e dates 15.12.2008, kam kerkuar Komisionit te Konkurrences te shqyrtoje qendrimin jo korekt te tyre.

V-Ndikimi dhe percaktimi i Organeve Tatimore në sjelljen e ndermarrjeve qe operojne ne tregun e karburanteve dhe ne tregje te tjera, per te patur nje sjellje te orientuar "bashkerenduar" ndaj cmimit te shitjes te karburanteve

Dukuria e orientimit, "bashkerendimit" të cmimeve të karburanteve nga organet shteterore, nuk vihet re vetem për çmimet e blerjes (vleren e cdoganimit-referenca doganore) pra nga Organet Doganore, por dhe për çmimin e shitjes nga Organet Tatimore ose nga Ministria e Financave.

Drejtesit e grupi i punës per hetimin e thelluar ne tregun e karburanteve jane njohur gjate veprimtarise se tyre ne Autoritetin e Konkurrences me praktiket e Drejtorisë së Pergjithshme të Tatimeve, me udhezimet perkatse per rivleresime tatimore dhe rivleresime te cmimeve te shitjes, ku u kerkohet nga ndermarrjeve qe te operojne me cmim te unifikuar me cmim te tregut<sup>20</sup>. Në Memo të datës 28.5.2008 thuhet "nga te dhenat duket qartë që çmimi i rivlerësimit është pothuajse i njëjtë (62 lek/l), kurse cmimi i aplikuar është i ndryshem ".Pra grupi i punes eshte njohur pisten ku me akte ligjore dhe nenligjore ose praktika në zbatim te tyre, imponohen kufizime te konkurrences nga organe shteterore. Kjo dukuri nuk vihet re vetem ne tregje per te cilen ben fjale Memo e dates 28.5.2008. Ajo nuk është nje dukuri e izoluar ne nje lloj te veçante tregu, por shfaqet në lloje të ndryshme tregjesh perfshi atë të karburanteve, jo vetem në Tirane por dhe ne rajone te tjera, jo vetem gjate periudhes hetimore kur eshte shtrire hetimi paraprak por edhe per periudhen qe perfshihet ne hetimin e thelluar.

Kjo dukuri e njohur me parë nga anetaret e grupit te punes, u be me dije edhe gjatë seancave degjimore ku midis te tjerash u tha:

"Ky është nje fenomen qe per mu duhet te ishte problem dhe shkaktar kryesor i disa deformimeve qe konstatohen lehtesisht nqse do te njiheni me udhezimet qofte ato fiskale doganore dhe teknike që rregullojne karburantet, ky treg vuan nga cenimi i lirise tij, prandaj ne pamjen e pare nga analiza juaj dhe une do te isha me ju, jep pershtypjen e çmimeve te kontrollume te inifikume dhe etj e tjer, por grupi nuk është thelluar duke mos kontaktuar me ne dhe ndoshta eshte lene

---

<sup>20</sup> Shih Memo e dates 28.05.2008, me numur protokollit 84 me titull Veprime te ndermarra ne lidhje me rivleresimin e Raportit Paraprak ne tregun e grurit dhe miellit ( bashkelidhur ), Vleresimi i cmimit te shoqerise X (shih Dosja Taçi Oil) gjate cdoganimit ne lidhje me cmimin e referencave doganore, Shih kopje te shkreses

per kete sence, te me falni se une proceduren nuk e njoh mire tuajen, jane keto vendime qe cenojne lirine e tregut qe pastaj deformatojne ne pamjen e pare edhe cmimet, ne c'kuptim? Duhet te njiheni me udhezimet dhe ligjet fiskale te cilat ne menyre totale dhe doganore tentojne te barazojne midis ekonomive cmimin si ne blerje ashtu dhe ne shitje”<sup>21</sup>

Ajo u bë me dije dhe nga evidencat shkresat e dërguara në Autoritetin e Konkurrencës.

Po kështu te tilla me këtë linjë, jane edhe dokumentat e sjella nga ndërmarrja e karburanteve nen hetim SHA...X.<sup>22</sup>Në shkresen e Drejtorise te Pergjithshme te Tatimeve –Dega e Tatim Paguesve të Medhenj, date 30.6.2006 me numur protokollit 8055/5 Njoftim vleresimi per Detyrimet, dhe Procesverbalin perkates nr 6, i mbajtur me 15.06.2006 thuhet:-nga kontrolli i kryer rezultoi: “Shoqeria gjate periudhave Tetor 2005, Nentor 2005, Dhjetor 2005 dhe Janar 2006 ka shitur artikullin benzine perkatesisht me cmime mesatare mujore me te ulta se çmimet mesatare mujore te shoqerive analogee ne treg. Bazuar ne ligjin nr 8560 date 22.12.1999 “per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise dhe konkretisht ne nenin 36, pika “c” i ndryshuar me ligjin nr 9333 date 06.12.2004 si dhe udhezimin e Ministrit te Financave nr 1 date 18.1.2005 “per procedurat tatimore ne Republiken e Shqiperise “ pika 2.2.3 si dhe Urdherin nga Kryetari i Deges se Tatimpaguesve te Medhenj nr 5055/3 prot date 14.06.2006 bejme rikarakterizimin e cmimeve si me poshte<sup>23</sup>

Pra, për diferencen midis çmimit te shitjes te benzines nga shoqeria dhe cmimit te shitjes ne treg, ndermarrjes ne fjale i kerkohet te vendose nje cmim sa cmimi i tregut dhe per rrjedhoje duhet te paguaje nje detyrim shtese tatimor, plus penalitet 50 % . Kjo eshte nje praktike e mirefillte antikonkurrese e imponuar dhe realizuar nga organet shtetore

Eshtë për të theksuar se këto praktika pune të Drejtorise së Pergjithshme të Tatimeve nuk jane praktika te izoluar që kane të bejne me veprimin e kontrollit të tatim paguesve të veçante, apo vetem në periudha jashte periudhes hetimore. Ne dosjen e hetimit te tregut te grurit dhe miellit ndodhet midis te tjerash Akt Kontrolli (vizite Fiskale) i Deges se Tatim Taksave Elbasan date 25.2.2008’ Ne te thuhet “*Nga te dhenat e mesiperme konstatohet se subjekti ka leshuar fature me cmim me te ulet se cmimi real i tregut, (korsivi eshte i imi) shkelje kjo e Nenit 57 te ligjit 7928 date 27.04.1995, pika 19.5 e udhezimit Nr 3 date 30.01.2006 per TVSH-ne Rikarakterizimi i situates tatimore behet mbeshtetur ne Autorizimin e Kryetarit te Deges se tatimeve Nr 242 prot .Date 25.02.2008 Pervec pagimit te TVSH shtese ka dhe gjobe per deklarim “fallco” prej 50 perqind.*

---

<sup>21</sup> Po aty faqe 3 me poshte.

<sup>22</sup> Shih Dosja e Hetimit te Karburanti 2008-2009 ne zyren e protokollit .Kthim pergjigje e shkreses sone Nr 55.

<sup>23</sup> Per me gjere Shih Procesverbali Nr 6 i mbajtur ne date 15.06.2006 në shoqerine “X “SHA...-Dosja e Hetimit te Karburantit 2008-2009 ne zyren e protokollit.

Per kete praktike flet dhe Njoftim vleresimi nr 12560.38 date 31.12.2007 dhe procesverbali ku penalizohet ndermarrja X SHA behet fjale se Rivleresimi i shitjeve me cmimet e pakices eshte bere ne zbatim te Ligjit Nr 7928 date 27.04.1995 "per TVSH-ne dhe Udhezimit Nr 3 date 30.01.2006 pika 11. gjithashtu mbeshtetur (mungon faqja).

E tille eshte shkresa e Drejtorise se Pergjithshme te Tatimeve Drejtoria Rajonale Tatimore Njesia e Tatimpaguesve te Medhenj Drejtoria e Kontrollit date 25.11.2008 me numur protokolli 16169/7, Njoftim Vleresimi per Detyrime Tatimore dhe Raporti i Kontrollit Tematik i dates 18/09/208. Ne thelb nepermjet ketyre rivleresimeve ndermarrjeve te karburantit u kerkohet dhe penalizohen qe tu referohen cmimeve te investiguara te derguara nga Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve. Per diferencen midis çmimit te shoqerise dhe cmimit te investiguar penalizohen. Pra praktikat e orientimit ndaj çmimeve të njëjta tregu (bashkerendimit te cmimeve) në shitje janë produkt i kërkesave nga Drejtoria e Përgjithshme Tatimeve dhe deget e saj.

Nga sa me siper dhe ne mungese e shmangie te vetedijshme të realizimit të nje hetimi objektiv e të paanshem nga ana e Grupit të Punes të ngarkuar për Hetimin e Thelluar ne Tregun e Karburanteve, qe nuk ben te mundur as identifikimin e deformimeve shtremberimeve të konkurrences se lire dhe efektive ne tregun e karburanteve, te shkaktareve reale te kufizimit te konkurrences ne kete treg, nuk mund të jem dakord dhe të miratoj dhe dispozitivin e këtij vendimi te Komisionit te Konkurrences Ky dispozitiv nuk ben te mundur mbrojtjen dhe rivendosjen e konkurrences se lire dhe efektive ne tregun e karburantit

Prandaj cmoj që për dispozitivin e vendimit të jap votën kundër.

KOMISIONER I KONKURRENCËS

Koço BROKA  
(\_\_\_\_\_)  
Anëtar